



POLITIKA NDËRKOMBËTARE DHE DIALOGU KOSOVË-SERBI

Anketa mbi Perceptimin e Qytetarëve

30 Janar 2023



POLITIKA NDËRKOMBËTARE DHE DIALOGU KOSOVË-SERBI

Anketa mbi perceptimin qytetarëve

30 Janar 2023

ANALIST I TË DHËNAVE

Dr Gëzim Visoka

Anketa është përgatitur nga PIPS në bashkëpunim me Fondacionin Konrad-Adenauer (KAS). Roli i autorit, Dr Gëzim Visoka, ka qenë kryesisht që të interpretojë dhe përmbledh të dhënat e anketës.

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë ato të Fondacionit Konrad-Adenauer (KAS), e as të anëtarëve të Bordit të Institutit për Studime Politike të Prishtinës (PIPS). Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet ose transmetohet pa lejen e PIPS-it.

Programi i Analizës së Politikës së Jashtme është themeluar nga Instituti për Studime Politike të Prishtinës në vitin 2014. Programi synon të analizojë dhe mbështesë integrimin euroatlantik të Kosovës, duke inicuar debat publik dhe duke prodhuar hulumtime mbi zhvillimet rajonale, evropiane dhe globale, si dhe efektet e tyre në pozitën ndërkombëtar të Kosovës.

Tabela e Përmbajtjes

8

Përmbledhje Ekzekutive

26

Perceptimi i qytetarëve për çështjet ndërkombëtare dhe rajonale

57

Perceptimi i qytetarëve për pozitën ndërkombëtare të Kosovës dhe dialogun me Serbinë

79

Aneksi 1: Metodologjia e hulumtimit



Përmbledhje Ekzekutive

Kosova po kalon nëpër një kohë sfiduese. Inflacioni i lartë i shkatuar nga pandemia Covid-19 dhe lufta në Ukrainë, së bashku me sfidat gjithnjë e më të mëdha socio-ekonomike lokale, siç janë migrimi, zhvillimi i ngadalshëm ekonomik dhe pasiguria politike kanë qenë disa nga çështjet më shqetësuese për shoqërinë kosovare. Përkundër këtyre sfidave, marrëdhënia e Kosovës me partnerët e saj ndërkombëtarë dhe dialogu me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve po e dominojnë agjendën politike në Kosovë. Veçanërisht rritja e tensioneve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës për zbatimin e marrëveshjeve teknike dhe politike jo vetëm që ka ndikuar negativisht në normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve dhe shoqërive, por ka ndikuar edhe në marrëdhëniet e Kosovës me partnerët e saj ndërkombëtarë. Përderisa kemi më shumë njohuri mbi pikëpamjet e palëve kryesore të interesit për zhvillimet globale dhe kombëtare, nuk dimë aq shumë se si këto dinamika kanë ndikuar në pikëpamjet e qytetarëve të Kosovës për një varg të gjerë çështjesh ndërkombëtare dhe kombëtare që po ndryshojnë me shpejtësi.

Ky raport përshkruan gjetjet kryesore të një ankete me qytetarët të realizuar gjatë nëntorit të vitit 2022 me 1056 të anketuar në Kosovë (për metodologjinë e hulumtimit shih Aneksin 1). Anketa është e ndarë në dy pjesë. Së pari, ajo analizon pikëpamjet dhe perceptimet e qytetarëve për një gamë të gjerë temash që kanë të bëjnë me çështjet ndërkombëtare të Kosovës dhe marrëdhëniet e saj me fuqitë dominuese rajonale dhe globale. Së dyti, anketa hulumton pikëpamjet dhe perceptimet e qytetarëve për çështjet më të ndjeshme në lidhje me pozitën ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me

Serbinë. Në përgjithësi, rezultatet e anketës tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë një opinion mjaft të qartë për udhëheqësit global, politikën ndërkombëtare dhe sigurinë. Sondazhi zbulon se qytetarët e Kosovës kanë një preferencë të qartë për vendet që shihen si promotor të paqes në botë dhe që mbështesin pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës. Sa i përket diplomacisë dhe pozitës ndërkombëtare të Kosovës, anketa vuri në pah se ndonëse shumica e të anketuarve janë të kënaqur me politikën e jashtme dhe diplomacinë e Kosovës, është një pjesë e konsiderueshme e popullsisë që nuk është aq e kënaqur. Për më tepër, anketa po ashtu zbulon se qytetarët ia atribuojnë përmirësimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës një vargu faktorësh, siç janë qeverisja e institucioneve kosovare dhe ndryshimet në politikën ndërkombëtare. Përveç kësaj, anketa thekson mungesën e informacionit publik rreth bisedimeve të udhëhequra nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe për iniciativën 'Ballkani i Hapur' dhe nevojën për mbulim më të besueshëm dhe mirë të informuar nga mediat, forumet publike ose format e tjera të angazhimit publik për të siguruar që qytetarët të jenë më të informuar për këto çështje. Në fund, anketa tregon se qytetarët e Kosovës nuk e mbështesin nismën e Ballkanit të Hapur dhe nuk besojnë se Kosova do të përfitojë nga zbatimi i saj dhe se ata e konsiderojnë Asociacionin e komunave me shumicë serbe si një rrezik të konsiderueshëm për shtetësinë e Kosovës. Përkundër këtyre shqetësimeve, anketa tregon se shumica e njerëzve në Kosovë shpresojnë se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të rezultojë në një marrëveshje përfundimtare, edhe pse është e paqartës se kur do të mund të arrihet ajo.

*Perceptimi i qytetarëve për
çështjet ndërkombëtare dhe rajonale*

Aleatët më të afërt



SHBA

68.5%



Gjermania

15.8%



**Mbretëria
e Bashkuar**

6.1%

SHBA mbetet aleati më i çmuar ndërkombëtar i Kosovës (68.5%) dhe shumica e të anketuarve e konsiderojnë atë si lider global në promovimin e paqes në botë, e pasuar nga Gjermania (15.8%) dhe Mbretëria e Bashkuar (6.1%). Të anketuarit besojnë se këto tri vende do të vazhdojnë të jenë aktorët më të fuqishëm në botë edhe në dy dekadat e ardhshme, ndërkohë që ata nuk presin që Kina apo India të tejkalojnë fuqitë botërore të sotme në të ardhmen e afërt.


*Perceptimi i qytetarëve për
çështjet ndërkombëtare dhe rajonale*

Liderët më të mirë globalë



**JOSEPH
BIDEN**

63%



**RECEP TAYYIP
ERDOGAN**

13%




**OLAF
SCHOLZ**

11%

Joseph Biden konfirmohet si lideri më i preferuar botëror në Kosovë me mbi 63%, i pasuar nga presidenti i Turqisë Rexhep Tajip Erdogan me 13% dhe kancelari gjerman Olaf Scholz me 11%. Ndër serbët e Kosovës, Vladimir Putin mbetet lideri i tyre më i preferuar botëror me 90%. Presidenti francez Emmanuel Macron gëzon një admirim shumë të ulët në Kosovë, me gjasë sepse ai nuk është aq i përfshirë në politikën e Kosovës sa Biden, Erdogan dhe Putin.

*Perceptimi i qytetarëve për
çështjet ndërkombëtare dhe rajonale*

Kërcënimet kryesore të sigurisë.



Shumica dërrmuese e të anketuarve shqiptarë të Kosovës, përkatësisht 93%, e konsiderojnë Serbinë si kërcënimin kryesor për sigurinë rajonale.


Megjithatë, 86% e serbëve të Kosovës e konsiderojnë Kosovën si kërcënimin kryesor për sigurinë rajonale. Kroacia renditet si kandidati kryesor për t'u bërë vendi më i fuqishëm në Ballkanin Perëndimor në dhjetë vitet e ardhshme.

*Perceptimi i qytetarëve për
çështjet ndërkombëtare dhe rajonale*

Partnerët kryesorë ekonomikë

Shumica e të anketuarve (41.2%) konsiderojnë se SHBA-ja duhet të jenë partneri kryesor ekonomik i Kosovës, pasuar nga Gjermania (20.4%), BE-ja dhe vendet anëtare të saj (20.6%) dhe Turqia (9.4%). Shumica e të anketuarve (36.7%) besojnë se Kosova duhet të kërkojë nga Kina që ta njohë Kosovën para se të investojnë, ndërsa të anketuarit e tjerë janë të hapur për investime kineze në Kosovë (17.7%) ose besojnë se investimet nga Kina duhet të pranohen, por me kushte të përshtatshme (20.6%).

SHBA	GJERMANIA
41.2%	20.4%
BE	TURQIA
20.6%	9.4%



*Perceptimi i qytetarëve për
çështjet ndërkombëtare dhe rajonale*

Lufta në Ukrainë

Shumica e qytetarëve të Kosovës janë të vetëdijshëm për implikimet e luftës në Ukrainë dhe rolin e Ruisë në përshkallëzimin e konfliktit.

91.6% e të anketuarve konsiderojnë se Vladimir Putin është përgjegjësi kryesor për përshkallëzimin e luftës në Ukrainë.



*Perceptimi i qytetarëve për
çështjet ndërkombëtare dhe rajonale*

**Organizatat ndërkombëtare
që kanë ndihmuar më së shumti**


Rreth 70% e të anketuarve e kanë renditur NATO-n si organizatën ndërkombëtare që e ka ndihmuar më së shumti Kosovën që nga viti 1999.

Gjithashtu, rreth 90% e të anketuarve e konsiderojnë NATO-n si një kontribues të fortë për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare në botë. Mbi 80% e të anketuarve e shohin pozitivisht edhe Bashkimin Evropian.



*Perceptimi i qytetarëve për
çështjet ndërkombëtare dhe rajonale*


Anëtarësimi në BE



Shumica e të anketuarve (mbi 73%) besojnë se Kosova do të anëtarësohet në BE brenda dekadës së ardhshme: mbi 40% besojnë se Kosova do të anëtarësohet në Bashkimin Evropian deri në vitin 2025, ndërsa rreth 30% e të anketuarve besojnë se Kosova do të anëtarësohet në BE deri në vitin 2030.

*Perceptimi i qytetarëve për
çështjet ndërkombëtare dhe rajonale*


Liberalizimi i vizave



Shumica e të anketuarve (44.7%) besojnë se vizat nga Bashkimi Evropian (BE) do të liberalizohen deri në vitin 2023, ndërsa 40% e të anketuarve besojnë se kjo do të ndodhë deri në vitin 2025.

*Perceptimi i qytetarëve për pozitën ndërkombëtare
të Kosovës dhe dialogun me Serbinë*




Diplomacia e Kosovës dhe pozita e saj ndërkombëtare



Përafërsisht 47.7% e të anketuarve janë shprehur se janë të kënaqur me politikën e jashtme dhe diplomacinë e Kosovës, ndërsa 30.8% janë shprehur se janë vetëm. Pavarësisht sfidave dhe pengesave të shumta, shumica e të anketuarve (60.8%) besojnë se pozita e Kosovës në arenën ndërkombëtare është përmirësuar në pesë vitet e fundit falë përmirësimit të qeverisjes së institucioneve të Kosovës.

Perceptimi i qytetarëve për pozitën ndërkombëtare të Kosovës dhe dialogun me Serbinë


Sa dinë qytetarët për dialogun me Serbinë



Shumica e qytetarëve kishin pak njohuri mbi dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (61.7%). Në përgjithësi, shumica (63%) e të anketuarve besojnë se e ardhmja e Kosovës si shtet i pavarur nuk do të rrezikohet nëse nuk arrihet një marrëveshje përfundimtare me Serbinë. Megjithatë, 26% besojnë se e ardhmja e Kosovës si shtet i pavarur varet nga arritja e një marrëveshjeje përfundimtare me Serbinë.

*Perceptimi i qytetarëve për pozitën ndërkombëtare
të Kosovës dhe dialogun me Serbinë*

Përfitimet nga një marrëveshje me Serbinë




Shumica e të anketuarve (41.8%) nuk besojnë se marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të përmirësojë jetën e tyre, duke treguar mungesë besimi të publikut në këtë proces dhe në rezultatet e tij. Nga 34.7% e të anketuarve që janë përgjigjur pozitivisht, 10.8% konsideronin se marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të përmirësojë jetën e tyre duke ofruar zhvillim ekonomik dhe lehtësojë liberalizimin e vizave (9.3%).

Shumica e të anketuarve (64.0%) theksojnë se nuk janë fare të informuar për përmbajtjen e propozimit të ri (franko-gjerman), ndërsa vetëm 25,9% e të anketuarve theksuan se janë pak të informuar.


Perceptimi i qytetarëve për pozitën ndërkombëtare të Kosovës dhe dialogun me Serbinë

Sa dinë qytetarët për propozimin franko-gjerman



*Perceptimi i qytetarëve për pozitën ndërkombëtare
të Kosovës dhe dialogun me Serbinë*


Nisma 'Ballkani i Hapur'



Shumica e të anketuarve besojnë se Kosova përfiton vetëm pak (10.3%) ose aspak (12.8%) nga zbatimi i nismës “Ballkani i Hapur”, ndërsa mbi 40% besojnë se ajo do të jetë e dëmshme për vendin.

Perceptimi i qytetarëve për pozitën ndërkombëtare të Kosovës dhe dialogun me Serbinë


Asociacioni i komunave me shumicë serbe (AKS)



97.6% e të anketuarve mendojnë se Kosova do të rrezikohej në rast të themelimit të AKS-së me kompetenca ekzekutive. Rreziqet kryesore kanë të bëjnë me funksionimin e institucioneve shtetërore të Kosovës dhe pamundësinë e Qeverisë së Kosovës që të shtrijë autoritetin e saj në të gjitha komunat e vendit. Megjithatë, vetëm 57.4% mendojnë se Kosova do të rrezikohej në rast të themelimit të AKS-së në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

*Perceptimi i qytetarëve për pozitën ndërkombëtare
të Kosovës dhe dialogun me Serbinë*

Përfundimi i dialogut me Serbinë



48% e të anketuarve, që janë kryesisht shqiptarë të Kosovës, besojnë se dialogu do të përfundojë me marrëveshje, ndërsa 27% nuk janë të sigurt dhe 24% mendojnë se nuk do të ketë marrëveshje në fund. Shumica e atyre që janë optimistë për zgjidhje, konsiderojnë se marrëveshja Kosovë-Serbi do të arrihet ose në vitin 2023 ose në tri vitet e ardhshme.



Perceptimi i qytetarëve për çështjet ndërkombëtare dhe rajonale


Ky seksion paraqet një pasqyrë të perceptimit të qytetarëve të Kosovës për çështjet kryesore ndërkombëtare dhe rajonale. Rezultatet e anketës tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë deri diku njohuri për peizazhin politik ndërkombëtar dhe çështjet globale. Të anketuarit kanë mendime të forta se kush duhet të konsiderohet promotor apo abuzues i paqes botërore dhe kush duhet të jetë partneri kryesor i Kosovës në politikën ndërkombëtare. Ata gjithashtu kanë mendim shumë të qartë se kush është përgjegjës për luftën në Ukrainë dhe çfarë duhet bërë nëse Kina ofron investime në Kosovë.

Përkundër faktit se pozita ndërkombëtare e Kosovës është ende e brishtë, rezultatet e anketës tregojnë se qytetarët e Kosovës e kanë të qartë se kush duhet të jenë partnerët e tyre dhe cili duhet të jetë roli i tyre në rajon. Nga anketa shihet qartë se qytetarët e Kosovës kanë një preferencë të fortë për SHBA-në, Gjermaninë dhe Mbretërinë e Bashkuar (MB) si fuqitë kryesore globale dhe si partnerët kryesorë diplomatikë dhe ekonomikë të Kosovës. Dashuria e qytetarëve të Kosovës për shtete të caktuara përkthehet edhe në simpati për liderët e tyre politikë. Gjetjet e anketës sugjerojnë se Joseph Biden është lideri më i preferuar botëror për shqiptarët e Kosovës, ndërsa Vladimir Putin mbetet lideri më i preferuar botëror për serbët e Kosovës. Anketa gjithashtu zbulon se qytetarët e Kosovës janë të vetëdijshëm për kërcënimet e mundshme që paraqesin Serbia dhe Rusia për sigurinë rajonale dhe fajësojnë presidentin rus Vladimir Putin për luftën në Ukrainë.

Për më tepër, rezultatet e anketës kanë demonstruar se qytetarët e Kosovës janë të vetëdijshëm për rolin e organizatave ndërkombëtare në rimëkëmbjen e Kosovës pas luftës dhe e dinë rolin e rëndësishëm që NATO ka luajtur në çlirimin e Kosovës dhe në garantimin e sigurisë gjatë periudhës së ndërtimit dhe konsolidimit të shtetit. Anketa po ashtu tregon se Bashkimi Evropian shihet pozitivisht nga qytetarët e Kosovës, përkundër disa çështjeve që janë ngritur në marrëdhëniet e tyre. Në fund, rezultatet e anketës sugjerojnë se qytetarët e Kosovës janë optimistë për perspektivën e liberalizimit të vizave me BE-në dhe presin që procesi i liberalizimit të vizave të përfundojë në një të ardhme të afërt.

1

Në shkallën nga 1 – aspak, deri në 5 - shumë, vlerësoni secilin nga vendet e mëposhtme bazuar në atë se sa mirë sillen ME VENDET E TJERA dhe sa kontribuojnë për paqen botërore.




Kapaciteti i shteteve për të promovuar paqen dhe sigurinë ndërkombëtare dhe për të pasur marrëdhënie miqësore me vendet e tjera është një tipar përcaktues i shtetësisë së përgjegjshme në politikën botërore. Megjithatë, paqja botërore gjithnjë e më shumë po hyn në një fazë të pasigurt dhe të brishtë që është evidente në kundërshtimin e fuqishëm të SHBA-së dhe BE-së ndaj luftës së Rusisë kundër Ukrainës dhe rritjes së tensioneve të Kinës mbi Tajvanin.

Prandaj, është thelbësore të kuptohet se si opinioni publik në Kosovë i percepton këto zhvillime globale dhe kush konsiderohet si promotor apo abuzues i paqes botërore. Ngjashëm me botimet e mëparshme, ne kërkuam nga të anketuarit të renditin secilin prej këtyre vendeve nga 1-5 (1 është shkalla më e ulët dhe 5 më e lartë) sipas asaj se sa mirë sillen ndaj shteteve të tjera dhe sa kontribuojnë për paqen botërore. Siç pritej, SHBA-ja konsiderohet lideri kryesor global në promovimin e paqes (4.2 nga 5) e ndjekur shumë afër nga Gjermania (4.1 nga 5) dhe Mbretëria e Bashkuar (3.9). Ndërkohë, Federata Ruse (1.7 nga 5) dhe Republika Popullore e Kinës (2 nga 5) konsiderohen më së paku promotorë të paqes në botë. Ndonëse këto gjetje janë kryesisht të njëjta me atë të anketave më të fundit të perceptimit të qytetarëve të kryera në vitin 2019, ka disa ndryshime të lehta. Krahasuar me rezultatet e këtij viti, në vitin 2019 Gjermania ishte konsideruar promotori kryesor global i paqes me një diferencë shumë të vogël nga SHBA-ja.

Ky ndryshim i lehtë në renditje është si rezultat i përfundimit të mandatit të Angela Merkel-it si kancelare gjermane, e cila ka gëzuar mbështetje të gjerë në Kosovë, dhe zëvendësimi i presidentit kontrovers Donald Trump me presidentin aktual Joseph Biden, i cili gëzon simpati të madhe në mesin e qytetarëve të Kosovës.

2

Cilat do të jenë tri vendet më të fuqishme në politikën ndërkombëtare në 20 vitet e ardhshme?



Derisa kontributi për paqen botërore është njëri prej treguesve se si shtetet shihen në nivel global, ka edhe përcaktues të tjerë të statusit ndërkombëtar, si forca ushtarake, ekonomike dhe demografike. Duke qenë se aktualisht po përjetojmë një transformim të shpejtë të rendit ndërkombëtar, duke përfshirë ngritjen e Kinës, është thelbësore të kuptojmë perceptimin e qytetarëve të Kosovës për liderët e ardhshëm botërorë.

Ne i pyetëm të anketuarit se cili nga tri vendet do të jetë më i fuqishmi në politikën ndërkombëtare brenda 20 viteve të ardhshme. Rezultatet e kësaj ankete sugjerojnë se qytetarët e Kosovës besojnë se SHBA-ja, Gjermania dhe Britania e Madhe do të vazhdojnë të jenë vendet më të fuqishme në botë në dy dekadat e ardhshme. Kjo nuk është befasuese, duke pasur parasysh statusin e tanishëm të këtyre vendeve si fuqi kryesore globale. 32% e të anketuarve konsiderojnë se SHBA-ja do të mbetet vendi më i fuqishëm në botë në 20 vitet e ardhshme, e ndjekur nga Gjermania (23%) dhe Mbretëria e Bashkuar (19%). Megjithatë, anketa gjithashtu tregon se qytetarët e Kosovës nuk presin që Kina apo Rusia t'i tejkalojnë fuqitë e sotme botërore në një të ardhme të afërt. Vetëm 11% e të anketuarve e konsiderojnë Kinën si vendin më të fuqishëm në politikën ndërkombëtare në 20 vitet e ardhshme, e pasuar nga Federata Ruse (8%).

Vetëm 1% e të anketuarve presin që India të jetë një fuqi kryesore globale në vitet e ardhshme. Fakti që Kina dhe India u renditën kaq ulët mund të jetë për shkak se nuk janë kuptuar projektet aktuale dhe të ardhshme të ngritjes globale ose mosbesimit në aftësinë e tyre për t'u bërë lojtarë kryesorë në arenën ndërkombëtare.

3

Cilin nga këta liderë botërorë e adhuron më së shumti?



JOSEPH BIDEN 63.3%



REXHEP T. ERDOGAN 13.3%



OLAF SCHOLZ 10.5%



JUSTIN TRUDEAU 3.8%



VLADIMIR PUTIN 3.7%



EMMANUEL MACRON 1.5%



RISHI SUNAK 1.4%


Tjerë 0.7%

Refuzoj të përgjigjem 1.9%

Ngjashëm me edicionet e mëparshme, ne kërkuam nga të anketuarit të zgjidhnin një opsion nga lista e liderëve më të shquar botërorë, duke lënë të hapur edhe mundësinë për të shtuar emra të tjerë. Këtë vit, presidenti i SHBA-së Joseph Biden konfirmohet si lideri më i preferuar botëror në Kosovë me mbi 63%, i ndjekur nga presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan me 13% dhe kancelari gjerman Olaf Scholz me 11%. Anketa po ashtu tregoi se liderët botërorë konsideroheshin ndryshe nga grupe të ndryshme etnike në Kosovë. Derisa Joseph Biden është lideri më i preferuar botëror për shqiptarët e Kosovës, lideri më i preferuar botëror për serbët e Kosovës është presidenti rus Vladimir Putin. Ndër serbët e Kosovës, Vladimir Putin mbetet lideri i tyre më i preferuar botëror me 90%. Kjo ndodh për faktin se serbët e Kosovës janë të ndikuar nga lidhjet e ngushta politike, ekonomike dhe fetare të Serbisë me Rusinë dhe kundërshtimi i kësaj të fundit ndaj pavarësisë së Kosovës. Nga ana tjetër, shqiptarët e Kosovës janë më të predispozuar të simpatizojnë shtetet perëndimore, të cilat kanë qenë më përkrahëse për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës. Në edicionin 2019 të këtij raporti, kancelarja gjermane Angela Merkel gëzonte simpati pak më të madhe në krahasim me presidentin e SHBA-së, Donald Trump. Në këtë edicion, qëndrimet kanë ndryshuar, me siguri sepse Joseph Biden është shumë i respektuar në Kosovë për përfshirjen e tij prej disa dekadash në zgjidhjen e konflikteve në Ballkan, ndërsa kancelari gjerman Scholz është një fytyrë e re në politikën evropiane dhe jo gjithaq i njohur në Kosovë. Ka gjithashtu një rritje të lehtë të popullaritetit të presidentit të Turqisë Erdogan në Kosovë (nga 10 në 13%). Kjo mund t'i atribuohet lidhjeve të forta ekonomike dhe politike të Erdoganit me Kosovën dhe mbështetjes së tij për pavarësinë e Kosovës. Së fundi, presidenti francez Emmanuel Macron gëzon një admirim shumë të ulët në Kosovë, me gjasë sepse ai nuk është aq i përfshirë në politikën e Kosovës sa Biden, Erdogan dhe Scholz.

4


Sa mendoni se kontribuon NATO për sigurinë dhe paqen në botë sot?



NATO vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në Ballkan dhe vepron si garantuesi kryesor i paqes dhe sigurisë në Evropë. Megjithëse NATO është një aleancë mbrojtëse dhe misioni i saj kryesor është mbrojtja e vendeve anëtare nga kërcënimet e jashtme, ajo e ka zgjeruar rolin e saj paqeruajtës përtej rajonit Euro-Atlantik. Prania e saj në Ballkan dhe rajone të tjera shihet si një forcë stabilizuese dhe angazhimi i saj për të mbështetur vlerat demokratike shihet si një kontribut i rëndësishëm për paqen dhe sigurinë globale. Në dritën e kësaj, ne kërkuam nga të anketuarit të komentojnë se sa mendojnë se NATO-ja kontribuon për sigurinë dhe paqen në botë sot. Shumica dërmuese e të anketuarve (90%) e konsiderojnë NATO-n si një kontribuese të fuqishme për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare në botë. Ky këndvështrim pozitiv për NATO-n rrjedh para së gjithash nga roli historik që paqeruajtësit e NATO-s kanë luajtur në çlirimin e Kosovës dhe duke shërbyer si garantuesi kryesor i sigurisë gjatë dy dekadave të rrugëtimit të Kosovës drejt shtetësisë së pavarur.

5


Cili nga shtetet në rajon është kërcënimi më i madh për sigurinë e Ballkanit Perëndimor?



Në dy dekadat e fundit, rajoni i Ballkanit ka pasur një stabilitet relativ; megjithatë, disa mosmarrëveshje të pazgjidhura në rajon, të shoqëruara me ndërhyrje të huaja të rrezikshme janë shfaqur si kërcënime të mëdha rajonale. Për shembull, ndarja jofunksionale e pushtetit në Bosnje dhe Hercegovinë dhe kërcënimet e përsëritura të Republikës Serbe për shpërbërje, së bashku me ngecjen e procesit të normalizimit të marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës, dhe çështje të tjera të pazgjidhura në Maqedoni të Veriut dhe Mal të Zi, paraqesin disa nga pikat kryesore të nxehta për destabilizim në rajon. Për më tepër, përplasjet midis BE-së dhe NATO-s, nga njëra anë, dhe Rosisë dhe fuqive të tjera të Lindjes së Mesme, nga ana tjetër, për kontrollin në rajon janë të prira të nxisin konflikte të mëtejshme rajonale. Në veçanti, tensionet dhe bllokadat e fundit në pjesën veriore të Kosovës dhe kërcënimi i Serbisë për përdorimin e forcës ushtarake, me mbështetje të fortë nga Rusia, kanë ringjallur frikën për një përshkallëzim të konfliktit në Kosovë. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, ne i pyetëm të anketuarit se cili nga shtetet në rajon e kërcënon më së shumti sigurinë e Ballkanit Perëndimor. Shumica dërmuese e të anketuarve, përkatësisht 93%, dhe shumica e shqiptarëve të Kosovës, e konsiderojnë Serbinë si kërcënimin kryesor për sigurinë rajonale. Ata që e renditën Kosovën si kërcënim (pak më shumë se 4%) ishin 86% nga komuniteti serb i Kosovës. Vendet e tjera në rajon nuk shihen si kërcënime të sigurisë për qytetarët e Kosovës.

6


Cili mendoni se do të jetë vendi më i fuqishëm në Ballkanin Perëndimor pas dhjetë vitesh?



Në lidhje me pyetjen e mëparshme, ne po ashtu kërkuam nga të anketuarit që të identifikonin se cilat vende në Ballkanin Perëndimor do të jenë më të fuqishmet në dhjetë vitet e ardhshme. 37.1% e të anketuarve konsiderojnë se sipas të gjitha gjasave Kroacia do të jetë vendi më i fuqishëm në rajon. Fuqia ekonomike dhe ushtarake e Kroacisë është tashmë evidente, me një ushtri të fortë dhe të modernizuar që po rritet në aftësi dhe kapacitet. Për më tepër, Kroacia ka lidhje të forta me BE-në dhe SHBA-në, gjë që i jep asaj një levë shtesë në marrëdhëniet rajonale. Ajo ndiqet nga Shqipëria me 33.3%, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia i ndjekin me përqindje shumë më të ulëta.

7


Zgjidhni tri vendet kryesore partnere të Kosovës në politikën ndërkombëtare.



Rruga e Kosovës drejt shtetësisë së pavarur dhe shtetndërtimit është bërë në koordinim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë. Meqenëse shtetësia e Kosovës është ende e brishtë dhe pozita e saj ndërkombëtare ende nuk është konsoliduar plotësisht, vendi mbështetet shumë në përkrahjen ndërkombëtare. Ngjashëm me edicionet e mëparshme, të anketuarve iu kërkua të zgjedhin dhe renditin tri shtete që ata i konsiderojnë si partnerët kryesorë të Kosovës në politikën ndërkombëtare. Të dhënat e anketës tregojnë se tri vendet partnere kryesore të Kosovës në politikën ndërkombëtare janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës (68.5%), Gjermania (15.8%) dhe Mbretëria e Bashkuar (6.1%). Shteti i afërm i Shqipërisë vlerësohet shumë dobët, ashtu sikurse Turqia, e cila është një nga partnerët kryesorë ekonomikë joperëndimorë të Kosovës. Posaçërisht, SHBA-ja ka qenë partner kyç për Kosovën, duke ofruar ndihmë ushtarake dhe financiare, përfshirë edhe mbështetjen për forcat e sigurisë së Kosovës dhe duke mbështetur përpjekjet e Kosovës për tu bërë pjesë e organizatave ndërkombëtare. Gjermania dhe Britania e Madhe po ashtu kanë qenë partnerë të rëndësishëm për Kosovën, duke ofruar mbështetje financiare dhe politike, si dhe duke mbështetur përpjekjet e Kosovës për t'iu bashkuar organizatave ndërkombëtare.

8


Cilinga aktorët apo shtetet e mëposhtme duhet të jetë partneri kryesor ekonomik i Kosovës?



Ekonomia paraqet një segment kyç të marrëdhënieve bilaterale të Kosovës me vendet e tjera dhe me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare. Megjithatë, Kosova vuan nga një deficit i konsiderueshëm tregtar. Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës të nxjerra në nëntor të vitit 2022 tregojnë se Kosova ka eksportuar vetëm rreth 70 milionë euro mallra gjatë viteve 2021-2022, ndërsa ka importuar një vlerë marramendëse prej mbi 475 milionë euro. Partnerët kryesorë të eksportit të Kosovës janë brenda BE-së, ku Gjermania, Italia dhe Holanda janë tre partnerët kryesorë. Në mënyrë të ngjashme, rreth gjysma e importeve të Kosovës vijnë nga BE-ja, përkatësisht nga Gjermania, Italia, Greqia dhe Sllovenia. Jashtë BE-së, Kosova kryesisht importon mallra nga Serbia dhe vendet e tjera të CEFTA-s, si dhe nga Turqia, e cila është një partner i madh tregtar. Deficiti i madh tregtar është pjesërisht si nënprodukt i prodhimit të kufizuar ekonomik të Kosovës dhe i mbështetjes në tregjet e huaja, por edhe si rezultat i qasjes së kufizuar dhe barrierave të vendosura ndaj vendit për më shumë se një dekadë. Të anketuarit janë pyetur se cili aktor besojnë se duhet të jetë partneri kryesor ekonomik i Kosovës. Sipas të anketuarve, partneri kryesor ekonomik i Kosovës duhet të jetë SHBA-ja, me 41.2% të të anketuarve që e zgjedhin atë si partner primar. Ajo pasohet nga Gjermania (20.4%), BE-ja dhe vendet anëtare të saj (20.6%) dhe Turqia (9.4%). Edhe pse aktualisht, tregtia e Kosovës me SHBA-në është fare simbolike, përcaktimi i qartë i të anketuarve për SHBA-në si partnerin kryesor ekonomik të Kosovës pasqyron faktin se SHBA-ja ka qenë mbështetësja kryesore e Kosovës që nga pavarësia e saj në vitin 2008 dhe i ka ofruar vendit ndihmë kyçe të sigurisë dhe diplomatike ndër vite. Këto rezultate sugjerojnë se të anketuarit kanë një preferencë të fortë që Kosova të thellojë partneritetin e saj ekonomik me SHBA-në dhe besojnë fuqishëm se SHBA-ja duhet të luajë një rol më aktiv në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Po ashtu ka një mbështetje të fuqishme për vazhdimin e marrëdhënieve tregtare me Gjermaninë, me vendet anëtare të BE-së dhe me Turqinë. Edhe pse Kosova mbështetet shumë në importet nga Serbia, të anketuarit nuk e kanë konsideruar atë si partner ekonomik për Kosovën. Kjo ndarje është ndikuar nga marrëdhëniet armiqësore politike dhe tensionet në rritje për shkak të shumë kontesteve të pazgjidhura.

9

Çfarë duhet të bëjnë institucionet kosovare nëse kompanitë kineze ofrojnë investime në Kosovë, si në vendet e rajonit?



Megjithëse tregu rajonal në Ballkanin Perëndimor dominohet nga BE-ja dhe shtetet perëndimore, Kina ka rritur investimet dhe tregtinë e saj në rajon. Marrëdhëniet tregtare të Kosovës me Kinën janë kryesisht simbolike për shkak të mungesës së marrëdhënieve diplomatike dypalëshe dhe dominimit të tregut të Kosovës nga tregjet dhe furnizuesit perëndimorë. Duke qenë të vetëdijshëm për rritjen e ndikimit global dhe rajonal të Kinës, ne i pyetëm të anketuarit se çfarë duhet të bëjnë institucionet kosovare nëse kompanitë kineze ofrojnë investime në Kosovë, si në vendet e rajonit. Në përgjithësi, shumica e të anketuarve (36.7%) besojnë se Kinës duhet t'i kërkohet të njohë Kosovën para se të investojnë në vend. 20.6% të tjerë mendojnë se investimet nga Kina duhet të pranohen, por me kushte të caktuara. Vetëm 23% e të anketuarve besojnë se investimet nga Kina nuk duhen të pranohen. Ky mendim ka të ngjarë të jetë për shkak të mungesës së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Kosovës dhe Kinës, si dhe dëshirës për të siguruar që investimet kineze të jenë të dobishme për popullin e Kosovës dhe të bëhen në mënyrë etike. Pavarësisht kësaj, rezultatet sugjerojnë se shumica e të anketuarve do të ishin të hapur ndaj investimeve kineze në Kosovë, por do të dëshironin që qeveria të sigurohet që kjo të bëhet në një mënyrë që respekton sovranitetin e Kosovës dhe që është e dobishme për popullin e Kosovës.

10

Kush është përgjegjës për përshkallëzimin e luftës në Ukrainë?



VOLODYMYR ZELENSKY 1.9%



VLADIMIR PUTIN 91.6%



BE 2.5%



SHBA 4.0%

Në muajin shkurt 2022, Rusia filloi një luftë të paprovokuar kundër Ukrainës, e cila është dënuar gjerësisht si një akt agresioni dhe si kërcënim serioz për sigurinë evropiane dhe ndërkombëtare. Pavarësisht këtij dënimi, konflikti mbetet i pazgjidhur dhe pa shpresë për një proces të paqes në të ardhmen e afërt. Lufta ka pasur një efekt shkatërrues jo vetëm mbi popullsinë e Ukrainës dhe ekonominë e tyre, por po ashtu ka nxitur kriza globale të karburantit dhe ushqimit, si dhe ka intensifikuar tensionet në konflikte të tjera të zgjatura në të gjithë Evropën dhe përtej saj. Tensionet dhe bllokadat e fundit në veri të Kosovës pjesërisht u janë atribuar grupeve të mbështetura nga Rusia, të cilat janë të implikuara në nisjen e luftës hibride në rajon për të minuar besueshmërinë e BE-së dhe NATO-s dhe për larguar vëmendjen nga lufta që është duke vazhduar në Ukrainë. Përderisa Qeveria e Kosovës ka mbajtur një qëndrim të qartë dhe ka dënuar ashpër luftën e Rosisë ndaj Ukrainës, ne kemi dashur të analizojmë pikëpamjet e qytetarëve të Kosovës për këtë çështje. Sipas të anketuarve, presidenti rus Vladimir Putin është përgjegjësi kryesor për përshkallëzimin e luftës në Ukrainë. 91.6% e të anketuarve ia atribuojnë përshkallëzimin e luftës Putinit, ndërsa 1.9% ia atribuojnë Presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky, 2.5% BE-së dhe 4.0% SHBA-së. Këto rezultate tregojnë se shumica dërrmuese e qytetarëve të Kosovës e mbështetin popullin ukrainas dhe e dënojnë luftën e paprovokuar ruse. Pikëpamjet e qytetarëve të Kosovës për luftën në Ukrainë pasqyrojnë opinionin e bashkësisë ndërkombëtare: se lufta e Rosisë në Ukrainë është një akt agresioni dhe një kërcënim serioz për sigurinë evropiane dhe ndërkombëtare. Derisa shumica e të anketuarve shqiptarë të Kosovës e fajësojnë presidentin rus Putin për përshkallëzimin e luftës në Ukrainë, serbët e Kosovës kryesisht ia atribuuan përgjegjësinë Presidentit të Ukrainës Zelensky (81%) dhe administratës së SHBA-së (57%). Rezultatet e anketës tregojnë se ka një ndarje të qartë në mesin e qytetarëve të Kosovës për atë se kush besojnë se është përgjegjës për përshkallëzimin e luftës në Ukrainë. Shumica e shqiptarëve të Kosovës janë të bashkuar në dëmtimin e gishtit kah presidenti rus Vladimir Putin, ndërsa serbët e Kosovës janë më të ndarë, disa që ia atribuojnë përgjegjësinë presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky dhe disa administratës së SHBA-së.

11


Cila organizatë ndërkombëtare e ka ndihmuar më së shumti Kosovën që nga viti 1999?




Rimëkëmbja e Kosovës pas luftës ka ndodhur falë ndihmës së madhe të ofruar nga organizatat rajonale dhe ndërkombëtare. Kjo mbështetje shtrihej që nga ndihma në rindërtimin e infrastrukturës bazë dhe shërbimeve publike e deri te ndërtimi i institucioneve politike dhe ekonomike dhe mbështetja e zhvillimit të ligjeve dhe politikave të reja të qeverisjes. Pavarësisht se i kanë ofruar Kosovës mbështetje për shtet-ndërtimin dhe ndërtimin e paqes, organizatat kryesore ndërkombëtare të pranishme në Kosovë kanë qenë neutrale ndaj statusit, duke lënë të kuptohet se ata kanë shmangur mbajtjen e qëndrimit për shtetësinë e pavarur të Kosovës. Meqenëse statusi politik i Kosovës mbeti i pazgjidhur prej vitit 1999 deri në vitin 2008 dhe më pas nuk u njoh plotësisht pas shpalljes së pavarësisë, perceptimi publik për misionet ndërkombëtare në Kosovë ka ndryshuar me kalimin e kohës. Në dritën e ndryshimit të natyrës dhe roleve të organizatave ndërkombëtare në Kosovë, ne kërkuam nga të anketuarit të listojnë se cila organizatë ndërkombëtare e ka ndihmuar më së shumti Kosovën që nga viti 1999. Në përgjithësi, rreth 70% e të anketuarve e kanë renditur NATO-n si organizatën ndërkombëtare që ka ndihmuar më së shumti Kosovën që nga viti 1999, e pasuar nga Kombet e Bashkuara (12.6%), Bashkimi Evropian (7.6%), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (9.7%) dhe Këshilli i Evropës (0.5%). Rezultatet e kësaj ankete tregojnë se shumica e të anketuarve e pranojnë rolin e rëndësishëm që ka luajtur NATO në çlirimin e Kosovës dhe në ofrimin e sigurisë gjatë periudhës së ndërtimit dhe konsolidimit të shtetit. Misioni KFOR i NATO-s ka ndihmuar në ofrimin e sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe ka qenë faktor kyç në parandalimin dhe menaxhimin e tensioneve të mëdha ndëretnike ose ndërkufitare në Kosovë. OKB-ja, BE-ja dhe OSBE-ja po ashtu kanë luajtur rol të rëndësishëm në rimëkëmbjen e Kosovës pas luftës, duke ofruar mbështetje për zhvillimin ekonomik, reformat institucionale dhe normalizimin e marrëdhënieve. Megjithatë, rezultatet e anketës sugjerojnë se perceptimi publik për këto organizata nuk është aq i fortë sa ai për NATO-n.

12

Sa pajtoheni me deklaratën se “Bashkimi Evropian (BE) është një organizatë miqësore e Kosovës sot”?



Bashkimi Evropian e ka mbështetur Kosovën në shumë mënyra që nga përfundimi i luftës në vitin 1999 dhe shpallja e pavarësisë në vitin 2008. Ai ka ofruar ndihmë financiare, mbështetje politike dhe marrëveshje tregtare, duke u bërë kështu donatori kryesor në Kosovë dhe duke siguruar fonde për infrastrukturë dhe projekte të tjera zhvillimore. Si rezultat, Bashkimi Evropian është aktori kryesor ndërkombëtar në Kosovë dhe anëtarësimi në BE mbetet një nga prioritetet kryesore kombëtare për Kosovën. Megjithatë, kriteret komplekse të anëtarësimit dhe reformat e mëdha të kërkuara institucionale, si dhe trajtimi i pabarabartë i Kosovës për shkak të mungesës së unitetit të brendshëm për pavarësinë e Kosovës, kanë qenë subjekt i debatit të rregullt politik dhe shoqëror në Kosovë. Në veçanti, politikat diskriminuese dhe vonesat dhjetëvjeçare në liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës shpesh kanë ngritur dyshime dhe pikëpyetje për marrëdhëniet e Kosovës me BE-në dhe perspektivat e saj për anëtarësim eventual. Në dritën e kësaj, ne kërkuam nga të anketuarit të vlerësojnë nëse BE-ja sot konsiderohet organizatë miqësore ndaj Kosovës. Rezultatet e kësaj ankete tregojnë se Bashkimi Evropian shihet pozitivisht nga të anketuarit, ku 67.4% e tyre pajtohen dhe 16.8% pajtohen plotësisht, pavarësisht disa çështjeve që janë ngritur në marrëdhëniet e tyre. Vetëm 13.4% e të anketuarve nuk pajtohen, dhe vetëm 0.5% e të anketuarve kanë refuzuar të përgjigjen. Ky mendim pozitiv ka të ngjarë të jetë për shkak të mbështetjes financiare dhe politike të BE-së për Kosovën, si dhe marrëveshjeve të saj tregtare dhe projekteve të tjera zhvillimore. Megjithatë, mosliberalizimi i vizave dhe trajtimi i pabarabartë i Kosovës për shkak të mungesës së unitetit të brendshëm mbi pavarësinë e Kosovës mbeten çështje kryesore që minojnë mbështetjen publike për BE-në në Kosovë.


13**Kur mendoni se Kosova do të anëtarësohet në Bashkimin Evropian (BE)?**

Pavarësisht reformave gjithëpërfshirëse, Kosova është ende në fazën e hershme të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA), e cila u nënshkrua në vitin 2015, dhe të përmbushjes së kriterëve politike dhe ekonomike për avancimin e procesit të integritimit në BE. Qeveria e Kosovës e ka bërë të qartë se është e përkushtuar për arritjen e reformave të nevojshme dhe përmbushjen e obligimeve të saj në kuadër të MSA-së për të përmbushur kriteret për anëtarësim në BE. Ndonëse progresi i Kosovës drejt integritimeve euroatlantike ka qenë i ngadalshëm, në vitin 2022 Qeveria ka ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm për avancimin e procesit të integritimit euroatlantik; siç janë aplikimi zyrtar për statusin e kandidatit për BE si dhe aplikimi për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Të dy proceset e plotësojnë njëri-tjetrin pasi konsiderohen vendimtare për rritjen e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës, të cilat janë kritere thelbësore politike për anëtarësim në BE. Raportet e fundit të BE-së për Kosovën po ashtu e pranojnë se institucionet e Kosovës kanë bërë përparim në organizimin e zgjedhjeve demokratike, reformën e administratës publike, përmirësimin e sistemit gjyqësor dhe luftimin e korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit. Për më tepër, meqenëse BE-ja ka aplikuar një metodologji më politike në procesin e zgjerimit, nuk duhet të përjashtohet mundësia që nëse Kosova dhe Serbia nënshkruajnë një marrëveshje ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve të tyre, mund të përshpejtohet rruga e anëtarësimit në BE. Më në fund, pas vonesave të gjata qytetarët e Kosovës pritet të udhëtojnë pa viza në zonën Schengen të BE-së në fillim të vitit 2024.

Duke marrë parasysh këto zhvillime, ne kemi kërkuar nga të anketuarit të ndajnë pikëpamjet e tyre për atë se kur ka gjasa që Kosova të anëtarësohet në BE. Shumica e të anketuarve (42.3%) besojnë se Kosova do të anëtarësohet në Bashkimin Evropian deri në vitin 2025. 31.4% e të anketuarve besojnë se Kosova do të anëtarësohet në BE deri në vitin 2030, 9.7% besojnë se do të anëtarësohet deri në vitin 2035, 4.8% besojnë se do të anëtarësohet pas vitit 2035, 9.4% nuk mendojnë se do të anëtarësohet ndonjëherë dhe 2.3% kanë refuzuar të përgjigjen. Ndonëse shumica e të anketuarve (mbi 73%) besojnë se Kosova do t'i bashkohet BE-së brenda dekadës së ardhshme, ky afat kohor ka të ngjarë të jetë jorealit duke pasur parasysh gjendjen aktuale të lodhjes nga zgjerimi dhe kriteret gjithnjë në rritje për anëtarësim në BE. Pavarësisht rrugës së gjatë përpara, Kosova nuk ka alternativë më të mirë se sa të mbetet e përkushtuar ndaj procesit të reformave dhe të vazhdojë progresin e saj drejt integritimit në BE. Qeveria duhet të vazhdojë të trajtojë çështjet politike dhe socio-ekonomike në mënyrë që të sigurohet që vendi të jetë gati për anëtarësim. Ngjashëm, bashkësia ndërkombëtare dhe vetë BE-ja duhet gjithashtu të mbeten të përkushtuara për të mbështetur procesin e integritimit euroatlantik të Kosovës dhe të punojnë për të ndihmuar vendin në përmbushjen e kriterëve për anëtarësim.

14

Kur mendoni se do të liberalizohen vizat nga Bashkimi Evropian (BE) për Kosovën?



Regjimi i vizave për të udhëtuar në BE ka qenë shumë i ngurtë për qytetarët e Kosovës. Megjithëse Kosova duhej të përmbushte një numër disproporcionalisht më të madh të kriterëve në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, dhe Komisioni Evropian në vitin 2018 arriti në përfundimin se Kosova kishte përmbushur me sukses kriteret për udhëtim pa viza, Këshilli i BE-së e ka vonuar procesin për arsye të brendshme politike. Po duket se, më në fund, në fillim të vitit 2024, qytetarët e Kosovës do të lejohen të udhëtojnë në zonën Schengen të BE-së pa viza, falë lobimit aktiv të Çekisë gjatë presidencës së tyre të BE-së gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022. Meqenëse qytetarëve të Kosovës u janë premtuar afate të shumta kohore për të udhëtuar pa viza brenda BE-së nga politikanët vendorë dhe ata të BE-së, ne i pyetëm të anketuarit se kur mendonin se do të ndodhte një proces i tillë. Shumica e të anketuarve (44.7%) besonin se vizat do të liberalizohen nga Bashkimi Evropian (BE) deri në vitin 2023. 40.7% e të anketuarve besonin se kjo do të ndodhte deri në vitin 2025, 7.7% besonin se do të ndodhte deri në vitin 2030, 5.6% besonin se nuk do të ndodhte kurrë dhe 1.4% refuzuan të përgjigjen. Rezultatet e kësaj ankete tregojnë se shumë qytetarë të Kosovës janë optimistë për perspektivën e liberalizimit të vizave me BE-në. Kjo ndoshta është për faktin se Komisioni Evropian tashmë ka konstatuar se Kosova i ka përmbushur kriteret për udhëtim pa viza dhe Këshilli i BE-së e ka vonuar procesin për arsye të brendshme politike. Rezultatet e anketës po ashtu sugjerojnë se shumica e qytetarëve të Kosovës presin që procesi i liberalizimit të vizave të përfundojë në të ardhmen e afërt (midis 2023 dhe 2025), që është në përputhje me afatin kohor të propozuar nga Çekia gjatë presidencës së tyre të BE-së në vitin 2022.


3

**Perceptimi i qytetarëve për
pozitën ndërkombëtare të
Kosovës dhe dialogun me Serbinë**

Ky seksion shqyrton perceptimin e qytetarëve për pozitën ndërkombëtare të Kosovës dhe përfitimet dhe rreziqet që lidhen me dialogun e lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Anketa më poshtë zbulon se përderisa shumica e qytetarëve kanë qenë ose shumë ose mjaftueshëm të kënaqur me politikën e jashtme të Kosovës, është e qartë se Kosova duhet të ndërmarrë hapa për të përmirësuar politikën e saj të jashtme dhe diplomacinë për tu siguruar se do të jetë në gjendje të arrijë objektivat e saj strategjike. Ndryshe nga pikëpamjet dominuese, anketa tregon se shumica e qytetarëve besojnë se e ardhmja e Kosovës si shtet i pavarur nuk do të rrezikohet nëse nuk arrihet një marrëveshje përfundimtare me Serbinë. Për më tepër, gjetjet tregojnë se qytetarët nuk e mbështesin nismën 'Ballkani i Hapur' dhe nuk besojnë se Kosova do të përfitojë nga zbatimi i saj. Në fund, anketa tregon se shumica e qytetarëve të Kosovës shpresojnë se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të rezultojë në një marrëveshje përfundimtare. Megjithatë, afati kohor për një marrëveshje të mundshme mbetet i paqartë.

15


Sa jeni të kënaqur me politikën e jashtme dhe diplomacinë e Republikës së Kosovës?



Viteve të fundit, politika e jashtme dhe diplomacia e Kosovës kanë përjetuar kufizime të shumta. Fushata agresive e Serbisë kundër njohjes dhe për çnjohje, si dhe ndryshimet e shpejta ndërkombëtare dhe gjeopolitike, përfshirë edhe lidhjen e integritit ndërkombëtar të Kosovës me normalizimin, kanë minuar objektivat e politikës së jashtme të Kosovës. Në një mjedis kaq të kufizuar, politika e jashtme e Kosovës është fokusuar në thellimin e marrëdhënieve bilaterale me aleatët ekzistues euroatlantikë. Brenda vendit, reformat aq të nevojshme institucionale dhe juridike të shërbimit të jashtëm të Kosovës e kanë penguar edhe aktivitetin diplomatik dhe kanë dëmtuar përpjekjet për të konsoliduar më tej subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës dhe anëtarësimin në mekanizmat shumëpalëshe. Ne i pyetëm të anketuarit se sa janë të kënaqur me politikën e jashtme dhe diplomacinë e Kosovës. Kënaqshmëria e përgjithshme me politikën e jashtme dhe diplomacinë e Kosovës duket të jetë e përzier. Përafërsisht 47.7% e të anketuarve janë shprehur se janë të kënaqur me politikën e jashtme dhe diplomacinë e Kosovës, ndërsa 30.8% janë shprehur se janë vetëm pak të kënaqur. 14.5% e të anketuarve janë shprehur se nuk janë aspak të kënaqur dhe 5.7% kanë thënë se janë plotësisht të kënaqur. Ndonëse mbi 50% e të anketuarve kanë qenë ose shumë ose mjaftueshëm të kënaqur me politikën e jashtme të Kosovës, është e qartë se Kosova duhet të ndërmarrë hapa për të përmirësuar politikën e saj të jashtme dhe diplomacinë për tu siguruar se do të jetë në gjendje të arrijë objektivat e saj ndërkombëtare.

16


Sipas jush, në pesë vitet e fundit pozita e Kosovës në arenën ndërkombëtare



Në lidhje me pyetjen e mëparshme, ne kemi kërkuar nga të anketuarit të ndajnë mendimin e tyre nëse pozita ndërkombëtare e Kosovës është përmirësuar në pesë vitet e fundit. Shumica e të anketuarve (60.8%) besojnë se pozita e Kosovës në arenën ndërkombëtare është përmirësuar në pesë vitet e fundit. Megjithatë, 25.2% besojnë se është dobësuar, 6.0% besojnë se është dobësuar shumë dhe 4.9% kanë refuzuar të përgjigjen. Këto rezultate sugjerojnë se edhe pse shumica e qytetarëve janë të kënaqur me përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për avancimin e pozitës ndërkombëtare të vendit, ende ka një pjesë të konsiderueshme të popullsisë që nuk janë aq të kënaqur. Në pyetje në vazhdim, të anketuarve iu kërkuar të sqaronin se çfarë e shpjegon përmirësimin apo dobësimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës. Faktori më i madh për dobësimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës duket të jetë fushata e Serbisë për çnjohje, e cila përbënte 42.5% të përgjigjeve. Kjo me siguri është për shkak të kundërshtimit të pavarësisë së Kosovës nga Serbia dhe përpjekjeve të saj për të minuar legjitimitetin e Qeverisë së Kosovës. Gjithashtu, 40.8% e të anketuarve ia atribuojnë përmirësimin e gjendjes qeverisjes së institucioneve kosovare, duke treguar se kishte probleme me mënyrën e strukturimit dhe menaxhimit të qeverisë. Ndryshimet në politikën ndërkombëtare po ashtu kanë qenë një faktor që e ka përcaktuar pozitën ndërkombëtare të Kosovës, duke përbërë 31.8% të përgjigjeve. Së fundi, faktorë të tjerë, si çështjet ekonomike apo sociale, po ashtu mund të kenë luajtur një rol në këtë situatë.


16.1

Pse mendoni se ndodhi kjo?



17


Sa mendoni se jeni të informuar për procesin e dialogut ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë të lehtësuar nga Bashkimi Evropian (BE)?



Dialogu i lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka qenë kryesisht një proces nga lart-poshtë që përfshin vetëm zyrtarë të lartë qeveritarë dhe ekspertë. Dialogu shpesh kritikohet për mungesë transparence, qartësie dhe informacioni të mjaftueshëm publik. Shoqëria civile dhe komunitetet e prekura vetëm simbolikisht janë konsultuar dhe përfshirë në procesin e vendimmarrjes. Në veçanti, roli i shoqërisë civile ka qenë njëdrejtimësh: vetëm promovimi i rëndësisë së normalizimit të marrëdhënieve pa pasur hapësirë të mjaftueshme në formësimin e procesit dhe rezultateve. Ngjashëm, për shkak të qasjes së kufizuar, gazetaria online dhe platformat e mediave sociale nuk kanë qenë në gjendje të raportojnë në mënyrë të drejtë dhe të balancuar. Kjo ka çuar në shpërndarjen e narrativave të njëanshme dhe shpesh në përhapjen e dezinformatave, të cilat kanë dëmtuar besimin e publikut dhe besueshmërinë e bisedimeve të udhëhequra nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në dritën e kësaj, ne i pyetëm të anketuarit se sa ishin të informuar për bisedimet e udhëhequra nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Shumica e qytetarëve kishin pak njohuri mbi dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (61.7%). 21.7% e qytetarëve nuk kishin njohuri për temën, 12.7% kishin shumë njohuri dhe 1.6% kishin njohuri të gjera. Në përgjithësi, është e qartë se qytetarët nuk janë të informuar mirë për bisedimet e udhëhequra nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Për të adresuar këtë, është thelbësore që BE-ja, Kosova dhe Serbia të rrisin përpjekjet e tyre për të përfshirë shoqërinë civile, komunitetet e prekura dhe mediat në proces dhe për të ofruar më shumë qartësi dhe informacione rreth bisedimeve. Kjo do të siguronte që qytetarët të jenë më të informuar dhe të kenë një opinion më të informuar mbi dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

18


A rrezikohet ekzistenca e Kosovës si shtet i pavarur në të ardhmen, nëse nuk arrihet “marrëveshja përfundimtare” me Serbinë?



Normalizimi i plotë i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përmes një marrëveshjeje ligjërish të detyrueshme është paraqitur si një proces qendror që përcakton të ardhmen politike të Kosovës. Marrëveshja konsiderohet qendrore për zgjidhjen e konfliktit të pazgjidhur me Serbinë, hapjen e rrugës për zhvillim socio-ekonomik dhe zhbllokimin e të ardhmes euroatlantike të Kosovës. Ashtu si është gjendja tani, ngecja e bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve ka rezultuar në thellimin e tensioneve etnike në Kosovë; lëkundjen e mbështetjes ndërkombëtare për Kosovën; dhe i ka mundësuar Serbisë që të nisë një fushatë diplomatike agresive për çnjohjen e Kosovës dhe bllokimin e perspektivave për anëtarësim në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare. Duke marrë parasysh këtë presion të imponuar ndaj Kosovës si nga aleatët ashtu edhe kundërshtarët e saj, ne kemi kërkuar nga të anketuarit të vlerësojnë nëse e ardhmja e Kosovës si shtet i pavarur do të rrezikohet nëse nuk arrihet një marrëveshje përfundimtare me Serbinë. Në përgjithësi, shumica e të anketuarve (63%) besojnë se e ardhmja e Kosovës si shtet i pavarur nuk do të rrezikohet nëse nuk arrihet një marrëveshje përfundimtare me Serbinë. Megjithatë, një pakicë e konsiderueshme (26.1%) e të anketuarve mendojnë se e ardhmja e Kosovës si shtet i pavarur do të rrezikohet nëse nuk arrihet një marrëveshje përfundimtare. 10.4% e të anketuarve kanë thënë se nuk e dinë nëse e ardhmja e Kosovës do të rrezikohet, ndërsa 0.6% kanë refuzuar të përgjigjen. Kjo sugjeron se ndonëse një numër i konsiderueshëm i të anketuarve e pranojnë rëndësinë e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, ata nuk besojnë se e ardhmja e tyre si shtet i pavarur varet nga kjo.

19


A besoni se “marrëveshja përfundimtare” mes Kosovës dhe Serbisë do të përmirësonte jetën tuaj?



Procesi i udhëhequr nga BE-ja për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka dalë të jetë si prioritet kyç ndërkombëtar dhe kombëtar në Kosovë, por nuk ka aq shumë debat se si një marrëveshje e tillë përfundimtare do të ndikonte apo përmirësonte jetën e përditshme të qytetarëve të Kosovës. Që nga viti 2011, Kosova dhe Serbia kanë arritur mbi 30 marrëveshje teknike dhe politike, por zbatimi i tyre i pjesshëm ose jo i kënaqshëm ka minuar besimin e publikut në proces, pasi shpesh publiku nuk e kupton qartë se si këto marrëveshje e përmirësojnë jetën e përditshme të qytetarëve të Kosovës. Prandaj ne i pyetëm të anketuarit nëse besojnë se marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do t'ua përmirësonte jetën. Rezultatet treguan se shumica e të anketuarve (41.8%) nuk besonin se marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të përmirësonte jetën e tyre, duke treguar kështu një mungesë besimi të qytetarëve në proces dhe në rezultatet e tij. Megjithatë, 34.7% e të anketuarve konsiderojnë se marrëveshja përfundimtare do të përmirësonte jetën e tyre. Në mesin e atyre që u përgjigjën pozitivisht, 10.8% mendonin se marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do t'ua përmirësonte jetën duke siguruar zhvillim ekonomik dhe 9.3% se mundësonte liberalizimin e vizave. Të tjerët besonin se marrëveshja përfundimtare do të përmirësonte sigurinë dhe stabilitetin në Kosovë, duke përfshirë njohjen reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Përkundër këtyre nuancave, megjë shumica e të anketuarve kishin një perceptim negativ mbi ndikimin e dialogut në jetën e tyre, ka nevojë për më shumë informacion dhe për të kuptuar më mirë se si marrëveshja përfundimtare do të përmirësonte jetën e qytetarëve të Kosovës.

20


Sa jeni të informuar për përmbajtjen e “Propozimit të ri (franko-gjerman)”?



Edhe pse është diskutuar shumë për nevojën e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për një periudhë të gjatë kohore të gjitha palët e përfshira nuk kanë qenë në gjendje të paraqesin një marrëveshje të tillë përfundimtare dhe ligjërish të detyrueshme. Në vitin 2022, një propozim franko-gjerman (tani i referuar si propozimi i BE-së) është parë si një përparim i mundshëm në ngërçin e gjatë midis Kosovës dhe Serbisë. Sipas raporteve, propozimi duket se sugjeron se Serbia do të marrë përfitime financiare dhe politike, siç është pranimi i shpejtë në BE, në këmbim të normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën, por pa njohje zyrtare diplomatike. Propozimi është pritur me reagime të ndryshme si nga Kosova ashtu edhe nga Serbia. Një aspekt qendror i këtij propozimi që mbetet i panjohur ka të bëjë me dispozitat dhe kompetencat e Asociacionit kundërthënës të komunave me shumicë serbe. Edhe pse këto dispozita të propozimit franko-gjerman kanë dalë në media, ka informacione të kufizuara publike të besueshme për përmbajtjen e vërtetë të propozimit. Kështu, ne i pyetëm të anketuarit se sa janë të informuar për përmbajtjen e propozimit franko-gjerman për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Shumica e të anketuarve (64.0%) theksuan se nuk janë fare të informuar për përmbajtjen e Propozimit të ri (franko-gjerman). 25.9% e të anketuarve u shprehën se janë pak të informuar, ndërsa 7.6% u shprehën se janë të informuar dhe vetëm 1.7% u shprehën se janë shumë të informuar. Rezultatet e kësaj ankete tregojnë qartë se më shumë se gjysma e të anketuarve nuk janë të informuar për përmbajtjen e propozimit franko-gjerman për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo mungesë informacioni me siguri është rezultat i informacioneve të kufizuara publike mbi përmbajtjen e propozimit. Edhe pse proceset paguebërëse janë diskrecionale dhe detajet mbahen sekrete, kjo mungesë informacioni është shqetësuese, duke pasur parasysh implikimet e mundshme të propozimit si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë. Që propozimi të fitojë mbështetjen e publikut dhe të jetë i suksesshëm, është e rëndësishme që qytetarët e Kosovës të kuptojnë implikimet e plota të propozimit përmes mbulimit më të besueshëm dhe më të mirëinformuar nga mediat, përmes forumeve publike ose formave të tjera të angazhimit publik.


21

Sa mendoni se përfiton Kosova nga zbatimi i 'Ballkanit të Hapur'?



22

Sa mendoni se dëmtohet Kosova nga zbatimi i “Ballkanit të Hapur”?



Një tjetër zhvillim i rëndësishëm rajonal që ka tërhequr vëmendje të konsiderueshme në Kosovë është iniciativa kundërthënëse për një zonë të përbashkët rajonale tregtare dhe të udhëtimit të njohur gjerësisht si nisma 'Ballkani i Hapur', e cila udhëhiqet nga Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Iniciativa për Ballkanin e Hapur është pritur me reagime të ndryshme në Kosovë. Nga njëra anë, disa e shohin iniciativën si një mënyrë për të krijuar një treg të përbashkët, për të lehtësuar tregtinë rajonale dhe për të hapur mundësi për qytetarët kosovarë që të udhëtojnë lirshëm në rajon. Në anën tjetër, të tjerët janë të shqetësuar se sovraniteti dhe shtetësia e Kosovës do të cenohet nëse ajo merr pjesë në iniciativë, pasi Serbia është nismëtarja dhe shtylla kryesore e projektit. Qeveria e Kosovës e ka kundërshtuar pjesëmarrjen në këtë nismë me arsyetimin se është e panevojshme pasi ka mekanizma të mjaftueshëm në kuadër të procesit të integritetit në BE, përfshirë edhe Procesin Ballkanik, i cili duhet të udhëheq bashkëpunimin dhe ndërlidhjen ekonomike rajonale. Për më tepër, Qeveria e Kosovës ka argumentuar se përderisa Serbia refuzon të njohë përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e barabartë të Kosovës si shtet sovran në forumet rajonale, kjo nismë do të mbetet e papranueshme. Përkundër këtyre argumenteve, në Kosovë ka pasur një debat të pamjaftueshëm dhe të bazuar në fakte për kostot dhe përfitimet e nismës për Ballkanin e Hapur. Në veçanti, është e paqartë nëse nisma do të sillte përfitime të prekshme ekonomike për Kosovën. Prandaj, ne i pyetëm të anketuarit

se sa mendojnë se Kosova do të përfitonte nga pjesëmarrja në nismën e Ballkanit të Hapur. Shumica e të anketuarve besojnë se Kosova përfiton vetëm pak (28.7%) ose aspak (35.6%) nga zbatimi i nismës për Ballkanin e Hapur. Vetëm 25.2% e të anketuarve theksuan se Kosova përfiton nga zbatimi i kësaj nisme. Megjithatë, kur bëhet fjalë për dëmin e mundshëm që vjen nga zbatimi i nismës së Ballkanit të Hapur, të anketuarit janë ndarë në mënyrë të barabartë mes atyre që mendojnë se kjo nismë do të dëmtojte Kosovën (41%) dhe atyre që mendonin ndryshe (42.2%). Me fjalë të tjera, 28.5% e të anketuarve theksuan se Kosova do të dëmtohet vetëm pak, ndërsa 13.7% aspak nga zbatimi i nismës për Ballkanin e Hapur. Nga ana tjetër, 25% u shprehën se Kosova do të dëmtohet shumë, ndërsa 16% jashtëzakonisht shumë nga zbatimi i kësaj nisme. Në përgjithësi, rezultatet e kësaj ankete tregojnë se qytetarët e Kosovës nuk janë entuziastë dhe përkrahës të nismës për Ballkanin e Hapur dhe nuk besojnë se Kosova do të përfitojë nga zbatimi i saj.

23

A rrezikohet Kosova në rast të themelimit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive?

97.6%

Kosova rrezikohet në rast të krijimit të një AKS me kompetenca ekzekutive

23.1

A rrezikohet Kosova në rast të themelimit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe sipas Gjykatës Kushtetuese?

57.4%

Kosova rrezikohet në rast të krijimit të AKS-së në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese

23.2

Cili është rreziku kryesor?

62.3%

Rrezikohet funksionimi i shtetit të Kosovës

73.0%

Komunat me shumicë serbe kërkojnë ndarje nga Kosova

77.8%

Serbia do të rrisë ndikimin e saj në Kosovë

53.6%

Qeveria e Kosovës nuk do të mund ta shtrijë autoritetin e saj në të gjitha komunat e Kosovës

Një nga aspektet më të diskutueshme të dialogut të udhëhequr nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është themelimi i Asociacionit të Komunave me shumicë serbe (AKS), i cili ishte përfshirë në marrëveshjen e arritur më 19 prill 2013. Pasi që Gjykata Kushtetuese e Kosovës në vitin 2016 konstatoi se disa dispozitat të kësaj marrëveshjeje bien ndesh me kornizën ekzistuese të të drejtave dhe rendin politik të Kosovës, Qeveria e Kosovës e ka refuzuar zbatimin e kësaj dispozite të marrëveshjes së Brukselit. Në mënyrë të ngjashme, Serbia ka refuzuar të zbatojë dispozitat e tjera të marrëveshjes së Brukselit. Një shqetësim i madh për Kosovën është shkalla në të cilën AKS do të minonte shtetësinë e Kosovës dhe do të çonte në mosfunksionimin institucional dhe


politik të saj. Duke marrë parasysh këtë, kemi kërkuar nga të anketuarit të komentojnë nëse Kosova do të rrezikohej në rast të themelimit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe. 97.6% e të anketuarve mendojnë se Kosova do të rrezikohej në rast të themelimit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive. Megjithatë, vetëm 57.4% mendojnë se Kosova do të rrezikohej në rast të themelimit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Kur të anketuarve iu kërkuar të specifikojnë më shumë pikëpamjet e tyre, 77.8% e tyre pohuan se rreziku kryesor në rastin e themelimit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe është se Serbia do të rrisë ndikimin e saj në Kosovë. Po kështu, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (73%) theksuan se një rrezik tjetër që lidhet me themelimin e AKS-së mund të jetë kërkesa e tyre për ndarje nga Kosova. Në mesin e të anketuarve serbë të Kosovës, 33% pajtohen se AKS do të ishte një rrugë për ndarjen e komunitetit të tyre nga Kosova. Të anketuarit renditën lartë edhe rreziqet që lidhen me funksionimin e institucioneve shtetërore të Kosovës (62.3%) dhe pamundësinë e Qeverisë së Kosovës për të shtrirë autoritetin e saj në të gjitha komunat e vendit (53.6%). Kështu, pikëpamjet popullore në Kosovë për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe në Kosovë duket se janë në përputhje me qëndrimin e Qeverisë së Kosovës për këtë çështje.

Ata e konsiderojnë AKS-në si një rrezik të konsiderueshëm për shtetësinë e Kosovës, si dhe kanë shqetësime serioze për rritjen e mundshme të ndikimit të Serbisë në Kosovë, kërkesën e tyre për ndarje dhe implikimet e mundshme në funksionimin e institucioneve shtetërore të Kosovës. Rezultatet e anketës sugjerojnë se Qeveria e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare duhet t'i qasen me kujdes çështjes së Asociacionit të Komunave me shumicë serbe dhe duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që asociacioni të mos e cenojë shtetësinë e Kosovës, integritetin institucional dhe politik.


24

A do të përfundojë dialogu i lehtësuar nga Bashkimi Evropian (BE) me një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?



24.1

Kur mendoni se do të arrihet marrëveshja Kosovë-Serbi?



Në fund, një pyetje enigmatike që ka marrë vëmendje të gjerë kohët e fundit është nëse dialogu i lehtësuar nga Bashkimi Evropian (BE) do të përmbyllet me një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pavarësisht afateve të ndryshme të përcaktuara nga ndërmjetësuesit dhe palët, aktualisht mbetet e paqartë nëse dialogu do të përmbyllet me një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kemi kërkuar nga të anketuarit të ndajnë pikëpamjet e tyre nëse dialogu i lehtësuar nga Bashkimi Evropian (BE) ka gjasa të përmbyllet me një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Të anketuarit janë të ndarë kur bëhet fjalë për mundësinë e një marrëveshjeje: 48% e të anketuarve, të cilët janë kryesisht shqiptarë të Kosovës, besojnë se dialogu do të përmbyllet me marrëveshje, ndërsa 27% nuk janë të sigurt dhe 24% mendojnë se në fund nuk do të ketë marrëveshje. Megjithatë, fakti që shumica e të anketuarve janë optimistë për mundësinë e një marrëveshjeje është inkurajues dhe sugjeron se ka disa pritje të publikut në Kosovë që një zgjidhje mund të arrihet në të ardhmen e afërt. Në një pyetje pasuese, ne kërkuam nga të anketuarit të ndajnë pikëpamjet e tyre për atë se kur ka gjasa të arrihet një marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Shumica e atyre që janë optimistë për zgjidhje, konsiderojnë se marrëveshja Kosovë-Serbi do të arrihet ose në vitin 2023 ose në tri vitet e ardhshme. Rreth 10% besojnë se do të duhen të paktën pesë ose më shumë vjet për të arritur një marrëveshje. Në përgjithësi, anketa tregon se shumica e njerëzve në Kosovë shpresojnë se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të rezultojë në një marrëveshje përfundimtare. Megjithatë, afati kohor për një marrëveshje të mundshme mbetet i paqartë, dhe të anketuarit janë të ndarë për atë se kur mund të arrihet ajo.



Aneksi 1: Metodologjia e hulumtimit

Ky anketë është kryer nga UBO Consulting gjatë muajit nëntor 2022 bazuar në pyetjet e hartuara nga PIPS në bashkëpunim me ASK-në. Anketa përfshin pikëpamjet e 1065 të anketuarve të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga të gjitha komunat e Kosovës, gjinitë, dhe që i përkasin dy grupeve kryesore etnike në vend. Mosha e të anketuarve sillet ndërmjet 18 dhe 65 vjeç. Identifikimi gjinor i të anketuarve ishte 49.9% femra dhe 50.1% meshkuj. Sa i përket përkatësisë etnike, ky edicion i anketës është fokusuar më së shumti në dy grupet etnike dominuese në Kosovë, përkatësisht 865 shqiptarë të Kosovës dhe 200 serbë të Kosovës, kryesisht pasi pyetjet e këtij viti kanë qenë më së shumti mbi dinamikën dhe marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo është bërë pa paragjykime për komunitetet e tjera pakicë në Kosovë, të cilat rregullisht janë përfshirë në studime dhe anketa të ndryshme. 60% e të anketuarve të përfshirë në anketë ishin nga zonat urbane, ndërsa 40% të tjerë nga zonat rurale. Në fund, anketa ka përfshirë të anketuar nga grupe të ndryshme socio-ekonomike.

Komuna	Shqiptarë	Serbë	Gjithsej
Prishtinë	96	0	96
Gjilan	47	7	54
Pejë	47	7	54
Prizren	84	0	84
Gjakovë	47	0	47
Podujevë	47	0	47
Vushtrri	37	7	44
Skenderaj	27	7	34
Leposaviq	0	26	26
Klinë	21	0	21
Mitrovicë	37	0	37
Istog	19	0	19
Deçan	21	0	21
Dragash	12	0	12
Suharekë	32	0	32
Rahovec	30	0	30
Viti	25	0	25
Kamenicë	18	11	29
Lipjan	29	0	29

Komuna	Shqiptarë	Serbë	Gjithsej
Shtime	13	0	13
Ferizaj	55	0	55
Kaçanik	18	0	18
Fushë Kosovë	15	7	22
Obiliq	11	0	11
Novobërdë	2	8	10
Zubin Potok	0	21	21
Shtërpce	2	8	10
Zveçan	0	21	21
Gillogovc	31	0	31
Malisheva	29	0	29
Junik	3	0	3
Mamushe	1	0	1
Han i Elezit	5	0	5
Gracanica	2	21	23
Ranillug	0	9	9
Partesh	0	7	7
Klllokot	0	7	7
Mitrovica e Veriu	2	26	28
	865	200	1065

 Str. Rexhep Luci, 15/ 5
Republic of Kosovo, 10 000
Prishtina

 +381 38 22 45 77

 info@pips-ks.org

 www.pips-ks.org

